

**KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN
E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

VENDIM

Nr. 2, datë 05.08. 2020

PËR

**RISHIKIMIN DHE FINALIZIMIN E “RREGULLORES SË ORGANIZIMIT TË
PUNËS SË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN”**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë; Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, Vendimit nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, si dhe Urdhrit nr. 6, datë 22.07.2020, “Për Koordinimin nga Qendra e Botimeve për diasporën të veprimtarisë së Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për Diasporën”, pasi diskutoi sipas rendit të ditës,

V E N D O S I:

1. Rishikimin dhe finalizimin e “Rregullores së organizimit të punës së Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e kësaj rregulloreje.

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Kryetare: Anila Ferizaj

Zëvendëskryetare: Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Arbër Salih

Z. Ymer Avdiu

Znj. Erida Koleci

Z. Edmond Ahmeti

Anëtarët:

Z. Isni Kryeziu

Znj. Feime Llapashtica

Znj. Evis Mastori

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi